Lezhë, më 31.10.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 31.10.2022, në orën 12:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e radhës të muajit Tetor 2022.
Mbledhja u hap nga Kryetari i Këshillit Bashkiak Lezhë, z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës si dhe 3 projekt vendimet shtesë.
Kërkoi fjalën z. Agostin Marku

Agostin Marku: Për pikën 1, është shtyrë disa herë dhe nuk është mirë. Ju e lexuat dhe unë po e ritheksoj. Unë e kam interpelancë me Kryetarin e Bashkisë dhe si rregull Kryetari i Bashkisë në interpelancë nuk mund të zëvendësohet nga askush.
Në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës. Nuk kam asgjë për ta kaluar në parim. Ka nja dy dosje që për mua janë shumë të rënda. Ne nuk u japim toka të vdekurve. U japim toka dhe pasuri të gjallëve. Diku i kanë rregulluar, diku nuk i kanë rregulluar. Është më mirë të tërhiqet nga administrata e bashkisë e të rregullohet. Dakord, pasardhësit e tyre do i marrin. Kaq kisha.

Ermal Pacaj – ZV/Kryetari i Bashkisë – Në lidhje me pikën 1 – Interpelanca është kërkuar me kryetarin e Bashkisë, gjithsesi meqë këtu jemi me drejtorin e Tokave, mund ta zhvillojmë, por është në dorën tuaj kjo pjesë. Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, për pjesën e emrave që janë,

Të kalojmë, që mos të vonohet si procedurë për to

Agostin Marku: Janë 12 vetë, ku 7 vetë që e kanë emrin atij janë të vdekur. Për 3 vetë thuhet e merr trashëgimtari, për 2 vetë thotë t'i miratojmë të ndjerit pikën pronat. Ne s'mund t'ia miratojmë atij, pasardhësit të tij po. Atij s'ia miratojmë dot. Se bëjmë gabim

Ermal Pecaj: Është procedurë ligjore, nuk besoj se është ashtu si thua ti. Nga Drejtoria e Bujqësisë do jetë dikush prezent në momentin që diskutohet projekt vendimi.

Ndue Luli: Meqënëse ky projekt vendim kërkon 3/5, të cilët nuk i kemi sot në sallë, e heqim sot nga rendi i ditës.

Atëherë e kalojmë në votim rendin e ditës pa pikën 1 (interpelanca), pa pikën 4 (pvendim "Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore") dhe me 3 pikat shtesë.

- Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Vazhdojmë me pikën 2 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Shtator 2022".

E hedhim në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e nivelit të tarifave,

tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato
administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e
vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve
ndaj kundravajtësve".
Në lidhje me këtë pikë, kush e do fjalën?
Ermal Pacaj: Ne kemi menduar për disa rregullime
në lidhje me Paketën fiskale. Për pjesën teknike
këtu është drejtori z. Dritan Boçi
- Hyri këshilltarja Marte Suka
- Doli këshilltari Gjon Ndoci.
- Hyri këshilltari Redi Brunga.
Dritan Boçi (drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore) -
- kemi bërë disa ndryshime kryesisht burokratike
për t'i vijmë në ndihmë kryesisht biznesit dhe
familjeve për paguajnë taksa dhe tarifave.
Një nga ndryshimet ka të bëjë me taksën e
fjetjes në hotel. Kemi vlerësuar për këtë taksë
të jetë 100 lekë, me shtesë prej 30 lekë për natë
për person. Gjithashtu, për sa i përket tarifave
të shërbimeve publike për Bashkinë Lezhë ka për
subjektet me aktivitet privat, kategorizimi ka qenë
në 5 nënndarje dhe kemi menduar ta reduktojmë
në 3 në bazë të xhiros vjetore për deklarojnë
në Tatime dhe përkatësisht fashat do jenë
0-8 mln, 8-30 dhe mbi 30. Sa i përket
taksave të përkohshme, këtë vit, do i dedikohet
një ndihmë shtresave në nevojë dhe është propozuar

një taksë prej 5000 lekë në vit për subjektet me totin fitimi, po vetëm për bizneset e mëdha.
Gjithashtu, te zëri i tarifave për shfrytëzimin e hapësirave publike, në zonën e parë kemi gjykuar që vlera të jetë jo 200 por 300 lekë/$m^2$ në muaj. Një tarifë shtesë është për përdorimin e mjeteve në lundrim që ndodhin gjatë verës, nuk ka qenë në vitet e mëparshme.
Këto janë pak a shumë ndryshimet që kemi propozuar në krahasim me Paketën Fiskale të një viti më parë.
Ndue Luli: Ka kush pyetje?
Agostin Marku: Është punuar mirë në parim, por unë jam pak konfuz te ndarja në 3 zona A, B, C, dhe të di nga ju që çfarë duhet kjo ndarje. Së dyti, te taksa e fjetjes në hotel, ju thoni që e keni rritur. Rritja është brenda ligjit dhe kompetencave që ka Këshilli, por në gjykimin tuaj, a është më mirë rritja e një takse apo zgjerimi i bazës? A do ishte më mirë dhe më efektive për zbatimin e Paketës Fiskale inventarizimi i gjithë resurseve që ka Lezha, duke filluar që nga bizneset, resortet, taksa e ndikimit në infrastrukturë, që shihet ku janë resurset dhe se mund të vendoset pastaj dhe niveli i taksave dhe ku jeni ju me këtë inventarizim të resurseve dhe se është

bashkëpunimi me institucionet, se po nuk pati, nuk e bën dot. Sa për agjent tatimor kemi vetëm Ujësjellësin, të tjerat i kemi pak a shumë kompetencat te njësitë administrative, te zyrat përkatëse. A kemi bërë ndonjë studim, a do jetë më efektive për këto taksa të mblidhen me agjent tatimor, një pjesë që ka peshën kryesore dhe sektori i taksave të kthehet më shumë në asistues dhe kontrollues i zbatimit të Paketës Fiskale. Tjetër, shoh diku te zënia e hapësirave publike, sidomos në sezonin e verës, ne kemi një problem të madh, që nuk është vetëm në Lezhë, është në gjithë Shqipërinë, raportet e plazheve publike me plazhet private. Ju, kur e kemi ndarë zonën bregdetare, e kemi ndarë në 4-5 zona, zonën më të preferuar e kemi 600 lekë m/muaj. Si për peshaken kjo.

Ermal Paçaj: Është në sezon

Agostin Marku: Në sezon, më keq, unë e kam marrë në muaj.

Ermal Paçaj: Sa i përket pyetjes së parë për fshatin, në fakt ndryshimi është në fashë dhe jo në zonë. Zona A është Lezha dhe Shëngjini ku ofrohet shërbimi më shumë se në zonat e tjera. Paguan më shumë ai që ndot më shumë.

Sa i përket pjesës tjetër, për inventarizimin e resurseve, ne kemi ndërmarrë hapa konkretë

për t'i dhënë një zgjidhje. Ne nuk kemi një databazë akoma sepse nuk kemi gjetur gjë dhe po punojmë që të ndërtojmë për pjesën e taksës familjare. Normalisht jemi konsultuar dhe me Drejtorinë e Kadastrës. Një pjesë e kanë me sistem, një pjesë e kanë me regjistra. Po bëhet një verifikim në formë censusi, me vetëdeklarim nga qytetarët. Besoj se kjo gjë do ndërtohet brenda 6-mujorit të parë të vitit që vjen. Pastaj çdo qytetar do e marrë njoftimin me telefon ose postë, që mos të ndodhë kjo historia vetëm kur vjen për të marrë një vërtetim

Ardian Nikulaj: Kishe diçka në lidhje me mbledhjen e taksave për shezllonet. Vjet është operuar që janë marrë lejet 3-4 muaj para fillimit të sezonit. Sivjet kështu do operohet prapë?

Ermal Pacaj: Për pjesën e taksës së shezllonëve, ministria është në fakt administratori. Ne jemi thjesht përfituesit, dmth jemi pala e tretë. Vitin që kaloi u hapën në shkurt aplikimet, sivjet aplikimet janë hapur në nëntor. Përgjigja që mund të jap është që për subjektet që do aplikojnë për herë të parë për stacionet e plazhit, normalisht duhet të bëhet brenda afatit 1-30 nëntor, kurse subjektet që janë me kontratë, kjo mund të ketë një afat më të gjatë, por gjithsesi taksat duhet të paguhen

para fillimit të sezonit. Por nuk e vendosim ne, nuk është një gjë që e kemi ne në dorë.

Ardian Nikulaj: Mirë do ishte të ishte operuar siç ke thënë sepse parapagimi është problem për shumë biznese.

Dritan Boçi: Duke parë se Drejtoria e Taksave është në rikonstruktim dhe është duke u ribërë dhe sistemi i ri i taksave, kemi punuar gjatë gjithë verës me inventarizimin e subjekteve. Po bashkëpunojmë ngushtë me Drejtorinë e Tatimeve, me QKB-në.
Me të dhënat që kemi marrë kemi bërë dhe verifikime në terren, ku dalin dhe probleme të tjera siç është mos legalizimi i subjekteve.
Sa i përket hotelerisë, jemi me mbi 208 subjekte të evidentuar që arrijnë një kapacitet prej 12000 shtretërish.

Agostin Marku: Për agjentët?

Dritan Boçi: Për agjentët, me ujësjellësin kemi bashkërenduar të dhënat mbi abonentët dhe kontratat që ata kanë me familjarët dhe mbi bazën e atyre të dhënave kemi projektuar dhe tarifat për vitin e ardhshëm. Është agjenti kryesor.

Ermal Pacaj: Gjëja nuk ke çeduar te agjenti, por te fakti që ne nuk kemi pasur databazë me të dhëna.

Agostin Marku: Paketa është vlerësuar. Është

bërë punë e mirë në letër, por problemi është në
praktikë. Duhet te pranojmë që Lezha është një
ndër bashkitë me më shumë resurse. Në parim unë
jam dakord që Lezha të ndahet në këto zona A, B, C
por kjo nuk mund të shërbejë për fitimet ato taksa
e tarifa të parashikuara. Jam shumë dakord për
taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe për taksën
e ndriçimit, por se i përket shërbimeve të tjera
taksa ndahet sipas kategorive, jo sipas zonave.
Me këtë dua të them që edhe edukohen njerëzit,
edhe të përfitoj qytetarët gjënë të barabartë
Unë them se një bashki e madhe siç është Bashkia
Lezhë duhet te kete në themel të saj agjentin
tatimor që të kete një Paketë Fiskale rezultative.
Në lidhje me hapësirat publike, me këtë tarifë
kushdo të shkojë e të vërë shezllone në plazh
dhe kështu plazhet publike për ata që nuk kanë
mundësi të paguajnë shezllonet janë të pakta.
* Doli këshilltari Marin Suta.
Ndue Luli: Atëherë nënkryetar.
Ermal Pacaj: Në lidhje me ndarjen e zonave,
është bërë sepse në zonën A jepet më shumë
shërbim, Sa i përket agjentit tatimor, nuk është
problem pjesë e mbledhjes së taksës së familjes,
thjesht ne nuk kemi patur një databazë. Sa i
përket pjesës së plazheve, plazhe publike kemi
më shumë se se lejon VKM-ja, kemi në

Kune, në Tale, në Vain, në Rancë e Hedhun.
Ardian Nikulaj: Të shtoj diçka në lidhje me plazhin publik. Se herë kishte zgjedhje trashin pse s'na vjen tregeti në Shëngjin, persona që nuk e kishin idenë se se kosto ka kjo gjë. Dikur u realizua dhe tregeti ereki bosh, veç 3 makina në të, derisa falimentuan kompanitë dhe u mbyll. Edhe puna e plazhit publik Agostin, pse e kërkojnë pikëvshet pore hotelit Rafaelo me ba plazh publik. A mundet me shku në Kune apo diku tjetër.
Agostin Marku: Në gjykimin tim, qytetari mundet me shku edhe në Kune por duhet të ketë edhe në qytet, jo pore hotelit.
Ermal Pacaj: Sa i përket pjesës së plazhit publik, në pendër të Shëngjinit po bëhet i kotënt vit që ka plazh publik. Në Shëngjin ka mjaftueshëm plazh publik për banorët aty. Edhe në Vain, Kune e te Rana e Hedhun ka plazhe publike, po ashtu edhe në Tale. Duhet bërë një balancë midis qytetarit por edhe biznesit që ka bërë investim aty.
Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera e hedhim projekt vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët pretendë përveç z. Agostin Marku që abstenoi.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që

është projekt vendim "Për miratimin e zbatimit të buxhetit faktike për 4-mujorin e dytë të vitit 2022 të Bashkisë Lezhë".
Ka kush diçka për diskutim?
Meqë nuk ka, e kalojmë p/vendimin për votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për disa ndryshime në V.K. Bashkisë nr. 177, datë 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024""
Ka kush diçka për diskutim?
Meqë nuk ka, e kalojmë p/vendimin për votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022".
Ka kush diçka për diskutim?
Meqë nuk ka, e kalojmë p/vendimin për votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Mendoj se para se të kalojmë te raporti të kalojmë 3 p/vendimet shtesë.
Atëherë p/vendimi i parë shtesë është "Për miratimin e marrëveshjes standarde midis Save the Children dhe Bashkisë Lezhë për projektin "Kënd lojrash" në shkollën 9-vjeçare "Marash Gjoni" Rilë, Lezhë".

- Në lidhje me plotësimin dhe një shpjegim të shumtit drejtori i projekteve z. Elson Frroku.
Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera e kalojmë projektvendimin për votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te projekt vendimi i dytë shtesë që është "Për miratimin e ndihmës financiare për znj. A.L. nga fondi i emergjencës".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë për votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te projekt vendimi i tretë shtesë që është "Për miratimin e ndihmës financiare për z. B.D. nga fondi i emergjencës."
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë për votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te Raporti mbi punën e Aleancës së Grave këshilltare Lezhë. Fjalën e ka këshilltarja Else Gotulli.
→ Znj. Else Gotulli referoi Raportin dhe falenderoi zonjat këshilltare që aktivizohen me Aleancën.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime te pika "Të ndryshme", unë ju falenderoj. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI